



Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur

Komuna e Rahovecit

31 Dhjetor 2011

Përmbajtja

Përmbledhja.....	2
1 Hyrje.....	5
2 Opinioni i auditimit.....	7
3 Gjendja e rekomandimeve të vitit paraprak.....	11
4 Rezultati financiar në krahasim me buxhetin e aprovuar.....	12
5 Pasqyrat Financiare – Pajtueshmëria me kornizën e raportimit dhe cilësinë e informatave.....	13
6 Menaxhimi Financiar.....	14
▪ 6.1 Të hyrat (duke përfshirë ato vetanake).....	14
▪ 6.2 Shpenzimet.....	15
▪ 6.3 Asetet.....	17
▪ 6.4 Trajtimi i borxheve.....	18
▪ 6.5 Raportimi kohor aktual ne procesin e pergjithshëm të buxhetit.....	19
7 Kontrollat e menaxhmentit.....	20
▪ 7.1 Sistemi i kontrollit të brendshëm.....	20
▪ 7.2 Sistemi I auditimit të brendshëm.....	20
8 Konkluzioni i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e Komunës së Rahovecit.....	21
Shtojca I. Format e ndryshme të opinionëve të auditimit bazuar në ISSAI 400.....	22
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	24
Shtojca III: Komentet e Komunës dhe përgjigjet e Auditorit.....	28

Përmbledhja

Grant Thornton Sh.p.k në emër të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Auditimi jonë është kryer në përpuethshmëri me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (“ONISA”) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion mbi pasqyrat financiare.

Ju lutem gjeni më poshtë një ekstrakt të marrë nga opinionimi jonë i auditimit nga faqja 7 e këtij dokumenti:

Sipas mendimit tonë, përveç impakteve të mundëshme të çështjeve të diskutuara në paragrafet 1 deri në 5 të bazës së opinionit të kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik bazuar në Paranë e Gatshme (“SNKSP”) Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore.

Porositë kryesore ndaj Kryetarit, të cilat na shpjen në kualifikim të opinionit janë:

1. Gjatë pregaditjes së pasqyrave financiare për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011 Komuna nuk ka bërë disa shpalosje të cilat kërkojnë nga SNKSP -Raportimi Financiar nën Kontabilitetin e Parasë së Gatshme dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore.
 - Në nenin 14 nuk ka shpalosje të informative mbi legjislacionin, aktivitetin dhe informatava tjera të nevojshme për Komunën e Rahovecit;
 - Neni 12 Pasqyra e pranimet dhe pagesave me para të gatshme nuk është kompletuar siç duhet nuk përputhet me shpalosjen 8;
 - Neni 15, shpalosja 35, balanca e të hyrave vetanake të pashpenzuara nuk është kompletuar siç duhet;
 - Pagesat nga palët e treta, në nenin 12, Pasqyra e pranimet dhe pagesave nuk është shpalosur për vitin që ka përfunduar me 31 Dhjetor 2011;
 - Neni 21 dhe 27 nuk janë të kompletuara;
 - Të arkëtueshmet (përdoret për organizata që arkëtojnë të hyra) nuk janë të kompletuara në mënyrë të duhur;

Prandaj ne nuk kemi qenë në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme mbi plotësinë dhe pajtueshmërinë informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare të Komunës për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011

2. Informacionet krahasuese për vitet 2010 dhe 2009 nuk janë të prezentuara në mënyrë të duhur:
 - Neni 12, Pasqyra e pranimit dhe pagesave me para të gatshme, nuk është kompletuar siç duhet për vitin 2010 dhe nuk përputhet me shpalosjen 8;
 - Neni 17 Balanca e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nuk është shpalosur siç duhet për vitet 2011, 2010 dhe 2009;
3. Komuna nuk mban listën e pagesave të palëve të treta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura ne sistemet operationale dhe të kontabilitetit për pagesat e palëve te trëta, si dhe për shkak të mungesës së kontrolleve alternative të implementuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryejmë teste të mjaftueshme dhe të përshtatshme që të verifikojmë kompletueshmërinë e pagesave nga palët e treta të njohura për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011;
4. Prona, pajisjet dhe impiantet të cilat janë në pronësi të Komunës janë shpalosur në pasqyrat financiare. Megjithatë, ka shumë mangësi dhe pasiguri që ndikojnë raportimin financiar të Komunës për pronën, pajisjet dhe impiantet, si vijon:
 - Balanca e pronës, pajisjeve dhe impianteve siç është shpalosur në pasqyrat e Komunës më 31 Dhjetor 2011 në shpalosjen 27, nuk është e harmonizuar me regjistrin e mjeteve themelore. Për më tepër, Komuna nuk e ka regjistruar pronën, pajisjet dhe impiantet në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (referuar si “SIMFK”)
 - Komuna nuk ka caktuar Komisionin për Vlerësimin e Pronës dhe nuk ka performuar ndonjë vlerësim të mjeteve themelore për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011. Është dashur të bëhet vlerësimi i pasurisë për të gjitha kategoritë e pasurisë: në përdorim, të dëmtuara, dhe të vlerësojë kërkesat për tjetërsim të pronës.

Për shkak të natyrës së regjistrimeve dhe mangësive të tjera të përshkruara më sipër, ne nuk ishim në gjendje për të kënaqur veten tonë me shpalosjet, ekzistencën, saktësinë, plotësinë dhe vlerësimin e pronës, pajisjeve dhe impianteve të Komunës më 31 Dhjetor 2011

5. Më 31 Dhjetor 2011 Komuna nuk ka bërë shpalosjen e llogarive të arkëtueshme në lidhje me tatimin në pronë, taksave biznesore, licencave, dhe taksave tjera të arkëtueshme të cilat janë të kërkuara të shpalosen sipas Rregulles Financiare 07/2011. Për më tepër, Komuna nuk mbanë regjistrime të kompletuara të debitorëve. Prandaj ne nuk ishim në gjendje të kënaqim veten tonë me balancën e llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2011.

Kontrollat e brendëshme

Auditimi ynë ka identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë përshkruar në detaje në raport. Konkluzioni ynë është që sistemet e brendshme të Komunës nuk janë projektuar siç duhet për të eliminuar dobësitë evidente dhe nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur. Në mënyrë që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne ju rekomandojmë që të siguronit se:

- Pasqyrat Financiare janë të pregaditura në përputhshmëri me udhëzimet administrative në fuqi dhe SNKSP;
- Mbahet një listë gjithëpërfshirëse e pronës, pajisjeve dhe impianteve;
- Mbahet një sistem automatik i të gjitha llojeve të tatimeve dhe taksave;
- Janë marrë masa për të rritur të hyrat nga taksat dhe tatimet e ndryshme;
- Është rrespektuar plotësisht ligji Nr. 03/L-241 i amendamentuar me Ligjin 04/L-042 mbi “Prokurimin Publik në Kosovë”;

Menaxhmentit të Komunës i është dhënë mundësia për të komentuar mbi të gjeturat e paraqitura në këtë raport. Menaxhmenti ka rënë dakord të bëjë të gjitha përpjekjet për të adresuar rekomandimet tona lidhur me sistemin e kontrollit të brendshëm, pasqyrat financiare, pronës, pajisjeve dhe impianteve, të prokurimit, borxheve dhe trajtimit të të arkëtueshmeve.

1. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Rahovecit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Është përgjegjësi e Komunës të përgadisë pasqyrat financiare në përputhshmëri me Rregullat Financiare 07/2011 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar nën Baza të Kontabilitetit me Paranë e gatshme”.

Grant Thornton LLC, në emër të Auditorit të Përgjithshëm, është përgjegjës për kryerjen e auditimit të rregullt vjetor të pasqyrave financiare të Komunës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

Auditimi përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, i cili përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e Pasqyrave Financiare dhe të dhënave të tjera financiare dhe siguron vlerësim:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të saktë për llogaritë dhe çështjet financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistement dhe transaksionet përputhen me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Në përshtatshmërinë e kontroleve të brendshme dhe funksionit të auditimit të brendshëm; dhe
- Për çfardo çështje të rëndësishme që rrjedh nga ose ndërlidhet me auditimin.

ZAP-i ka kryer auditimin e ndërmjetmë të Komunës. Gjatë asaj periudhe të procesit të auditimit i kanë adresuar zgjidhjen e rekomandimeve të dhëna më herët Komunës si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Bazuar në këtë ata kanë dhënë rëkomandime për menaxhmentin. Rekomandimet e tyre kanë përfshirë gjithashtu këshilla lidhur me përmirësimet për pasqyrat financiare që të jenë në përputhshmëri me Rregullën Financiare 07/2011 dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (“SNKSP”) për “Raportimin Financiar të Kontabilitetit në Baza të parasë së gatshme”. Kjo është e përfshirë gjithashtu si këshillë lidhur me përgatitjen e Pasqyrave Vjetore Financiare. Rekomandimet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm janë dorëzuar nëpërmjet memorandumit të auditimit të datës Dhjetor 2011.

Në mënyrë që të përmbushet përgjegjësia jonë për auditimin e Komunës, ne kemi ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:

- Kemi krahasuar Pasqyrat Vjetore Financiare të komunës me buxhetin e aprovuar për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011;
- Kemi përcaktuar nëse Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës janë përgaditur në përputhshmëri me SNKSP “Raportimi Financiar i Kontabilitetit në Baza të parasë së gatshme” dhe Rregulla Financiare 07/2011;

- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, si prag për lehtësim në përcaktimin e llojit të mendimit që duhet dhënë për pasqyrat financiare;
- Kemi përdorur një kombinim të gjykimit dhe mostrimit të thjesht për të përzgjedhur transaksionin për testim;
- Kemi kryer teste substanciale të transaksioneve financiare; dhe
- Jemi mbështetur në një kombinim të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumentave dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe drejtësinë e transaksioneve financiare;

Në këtë raport ne përmbledhim gjetjet e auditimit dhe sigurojmë mendimin tonë për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

ONISA ka vendosur kritere të veçanta që përcaktojnë llojin e mendimit që do duhet dhënë në lidhje me mendimin tonë të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Komunës.

Janë të vëna në mënyrë më të plotë në Shtojcën 1.

2. Opinioni i Auditimit

Raporti i auditorit të pavarur

Grant Thornton LLC
 Rr. Rexhep Mala 18
 10 000 Prishtina
 Republic of Kosovo

T +381 38 247 771
 T +381 38 247 801
 F +381 38 247 802
www.grant-thornton.com.mk

Për Kuvendin Komunal
 Komuna e Rahovecit, Kosovë

Ne kemi audituar pasqyrat përcjellëse financiare të Komunës së Rahovecit (“Komuna”), të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pranimeve dhe Pagesave në Para të Gatshme për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011, Raportin e Ekzekutimit të buxhetit, si dhe një përmbledhje të politikave më të rëndësishme kontabël si dhe shënime të tjera sqaruese

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (“SNKSP”) Bazuar në Paranë e Gatshme Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe me Udhëzimin Administrativ Nr. 07/ 2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore dhe për kontrollin të brendshëm menaxhmenti përcakton nevojshmërinë për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me standardet ndërkombëtare të hartuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (ONISA). Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi të auditimit lidhur me shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga ndonjë gabim ose mashtrim. Gjatë vlerësimit të riskut, auditori konsideron kontrollin e brendshëm të përshtatshëm për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim që të dizajnojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në ato rrethana, por jo për qëllimin e shprehjes së një mendimi mbi

efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezentimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmia e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e duhur për të siguruar bazë për mendimin tonë të kualifikuar.

Bazat për Opinion të Kualifikuar

1. Komuna nuk ka bërë disa shpalosje të cilat kërkohen nga SNKSP -Raportimi Financiar nën Kontabilitetin e Parasë së Gatshme dhe Rregulles Financiare Nr. 07/2011 mbi *Raportimin Vjetor Të Organizatave Buxhetore*. Në veçanti, çështjet e paraqitura më poshtë janë lënë jashtë ose janë shpalosur në mënyrë të parregullt në pasqyrat financiare:

- Në nenin 14 nuk ka shpalosje të informatave mbi legjislacionin, aktivitetin dhe informatat tjera të nevojshme për Komunën e Rahovecit
- Neni 12, Pasqyra e pranimi dhe pagesave me para të gatshme nuk është kompletuar në mënyrën e duhur dhe nuk përputhet me shpalosjen 8.
- Neni 15, shpalosja 35, balanca e të hyrave vetanake të pashpenzuara nuk është kompletuar në mënyrën e duhur.
- Pagesat nga palët e treat, në nenin 12 Pasqyra e pranimi dhe pagesave nuk është shpalosur për vitin që ka përfunduar me 31 Dhjetor 2011.
- Nenet 21 dhe 27 nuk janë të kompletuara.
- Të arkëtueshmet (përdoret për organizata që arkëtojnë të hyra) nuk janë të kompletuara në mënyrë të duhur.

Prandaj ne nuk kemi qenë në gjendje të arrijmë siguri të arsyeshme mbi plotësinë dhe pajtueshmërinë rregullore të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare të Komunës për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011.

2 Informacionet krahasuese për vitet 2010 dhe 2009 nuk janë të prezentuara në mënyrë të duhur:

- Neni 12, Pasqyra e pranimi dhe pagesave me para të gatshme nuk është kompletuar në mënyrën e duhur për vitin 2010 dhe nuk përputhet me shpalosjen 8.
- Neni 17, Balanca e të hyrave vetanake të pa shpenzuara, nuk është shpalosur në mënyrën e duhur për vitet 2011, 2010 dhe 2009.

3 Komuna nuk e mban listën e pagesave të palëve të treta. Për shkak të natyrës së regjistrimeve të mbajtura në sistemetet operacionale dhe të kontabilitetit për pagesat e paleve të treta, si dhe për shkak të mungesës së kontrolleve alternative të implementuara nga menaxhmenti, ne nuk ishim në gjendje të kryejmë teste të mjaftueshme dhe të përshtatshme që të verifikojmë kompletueshmërinë e pagesave nga palët e treta të njohura për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011.

- 4 Prona, pajisjet dhe impiantet të cilat janë në pronësi të Komunës janë shpalosur në pasqyrat financiare. Megjithatë, ka shumë mangësi dhe pasiguri që ndikojnë raportimin financiar të Komunës për pronën, pajisjet dhe impiantet, si vijon:
- Balanca e pronës, pajisjeve dhe impianteve siç është shpalosur në pasqyrat e Komunës më 31 Dhjetor 2011 në shpalosjen 27, nuk është e harmonizuar me regjistrin e mjeteve themelore. Për më tepër, Komuna nuk e ka regjistruar pronën, pajisjet dhe impiantet në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (referuar si “SIMFK”).
 - Komuna nuk ka caktuar Komisionin për Vlerësimin e Pronës dhe nuk ka performuar ndonjë vlerësim të mjeteve themelore për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011. Është dashur të bëhet vlerësimi i pasurisë për të gjitha kategoritë e pasurisë: në përdorim, të dëmtuara, dhe të vlerësorë kërkesat për tjetërsim të pronës.

Për shkak të natyrës së regjistrimeve dhe mangësive të tjera të përshkruara më sipër, ne nuk ishim në gjendje për të kënaqur veten tonë me shpalosjet, ekzistencën, saktësinë, plotësinë dhe vlerësimin e pronës, pajisjeve dhe impianteve të Komunës më 31 Dhjetor 2011.

5. Më 31 Dhjetor 2011 Komuna nuk ka bërë shpalosjen e llogarive të arkëtueshme në lidhje me tatimin në pronë, taksave biznesore, licencave, dhe taksave tjera të arkëtueshme të cilat janë të kërkuara të shpalosen sipas Rregulles Financiare 07/2011. Për më tepër, Komuna nuk mbanë regjistrime të kompletuara të debitorëve. Prandaj ne nuk ishim në gjendje të kënaqim veten tonë me balancën e llogarive të arkëtueshme më 31 Dhjetor 2011.

Opinion i Kualifikuar

Sipas mendimit tonë, përveç impakteve të mundshme të çështjeve të diskutuara në paragrafet 1 deri 5 të bazës së opinionit të kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe pagesat për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2011 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik bazuar në Paranë e Gatshme (“SNKSP”) Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Bazuar në Paranë e Gatshme dhe Rregullës Financiare Nr. 07/2011 mbi Raportimin Vjetor të Organizatave Buxhetore.

Rishikimi i Përputhshmërisë

Përveç auditimit të pasqyrave financiare, është planifikuar dhe kryer një rishikim i përputhshmërisë për të shprehur një konkluzion me siguri të kufizuar nëse në të gjitha aspektet materiale, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato. Natyra, koha dhe masa e punës për përputhshmërinë e kufizuar të krahasuar me atë të hartuar për të shprehur një opinion me siguri të arsyeshme për pasqyrat financiare

Përgjegjësia e menaxhmentit për përputhshmërinë

Menaxhmenti është përgjegjës për pregaditjen dhe implementimin e kontrolleve të brendshme për të siguruar se aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni i paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me autoritetet që i qeverisin ato.

Përgjegjësia e auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një konkluzion bazuar në rishikimin tonë. Puna jonë është kryer në përputhje me ISSAI 4200 *Udhëzimet mbi Auditimin e Përputhshmërisë Lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Këto parime kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe kryejmë rishikimin për të arritur një siguri të kufizuar nëse aktivitetet, transaksionet financiare

dhe informacionet e reflektuara në pasqyrat financiare janë në përputhje, në të gjithë aspektet materiale me autoritetet që i qeverisin ato.

Një rishikim është i kufizuar kryesisht në procedura analitike dhe intervista, dhe për këtë jep më pak siguri se një auditim. Ne nuk kemi kryer një auditim, dhe për këtë arsye, ne shprehim konkluzionin tonë në formën e një sigurie të kufizuar, e cila është konsistente me punën e kufizuar që ne kemi kryer për këtë rishikim përputhshmër

Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e përshtatshme dhe e mjaftueshme për të dhënë një bazë për konkluzionet tona.

Konkluzioni mbi përputhshmëria

Bazuar në rishikimin tonë, për shkak të ndikimit në pasqyrat financiare të çështjeve të shpjeguara në paragrafët 1 deri 5 të “bazat për mendim të kualifikuar” dhe çështjeve të tjera të theksuara në pikat 3 dhe 8 të këtijë raporti, aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet e pasqyruara dhe pasqyrat financiare që duhet të kenë vëmendjen tonë gjatë rishikimit, nuk janë në përputhshmëri me autoritetet që i qeverisin ato..

Çështje të tjera

Ne tërheqim vëmendjen si më poshtë:

1. Burimi kryesor i besueshëm i informacionit për përgatitjen e pasqyrave financiare është SIMFK. Megjithatë, pasi që SIMFK nuk është duke u përdorur për regjistrimin e pagesave nga palët e treta, pronën, pajisjet dhe impiantet ose të arkëtueshmet, nuk mund të përdoret për të pregaditur pasqyra financiare gjithëpërfshirëse.
2. Edhe pse Kryetari i Komunës dhe Zyrtari Kryesor Financiar kanë nënshkruar Deklaratat lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare, Komuna nuk ka qenë në gjendje të dorëzojë një draft final të pasqyrave financiare në gjuhën serbe deri në fund të auditimit tonë.
3. Komuna nuk ka zbatuar një sistem gjithëpërfshirës dhe të automatizuar të faturimit dhe nuk mban lista apo llogari të veçanta e complete për të gjithë debitorët e saj në lidhje me taksat e ndryshme. Vetëm mbledhja e parasë së gatshme nga niveli i të hyrave regjistrohet. Mungesa e saktësisë dhe tërësisë do të ndikojnë në të ardhurat që Komuna mund të fitojë dhe aftësinë për të përgatitur një buxhet të besueshëm dhe të saktë për të raportuar një normë të saktë të mbledhjes, si dhe monitorimin e mbledhjes së të ardhurave vetanake në kohën e duhur
4. Ne kemi identifikuar disa raste të mosrespektimit të ligjit Nr. 03/L-241 dhe 04/L-042 “Ligji mbi Prokurimin Publik në Kosovë” (i amendamentuar). Mos përputhje të tilla janë të lidhura me procedurat e kërkuara, të cilat komuna nuk i ka kryer dhe dokumentuar.
5. Megjithëse Komuna mund të jetë e përfshirë në disa raste të vogla ligjore dhe është e mundur që rrjedha e parasë në të ardhmen mund të kërkohej në të ardhmen, Komuna nuk ka dizajnuar dhe zbatuar asnjë procedurë për informacione të plota, të sakta dhe të besueshme për regjistrimin e provizioneve dhe detyrimeve kontigjente

Grant Thornton LLC

Prishtinë, Kosovë
 29 Qershor 2012

3. Gjendja e rekomandimeve të vitit paraprak

Letër menaxhmenti ynë, për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2010, ka identifikuar pesë rekomandime kryesore. Një nga këto rekomandime në lidhje me krijimin dhe funksionimin e komiteit të auditimit është zgjidhur, përderisa katër rekomandimet tjera ende mbeten të adresohen tërësisht:

- Pasqyrat Financiare duhet të pregaditen në përputhshmëri me udhëzimet administrative në fuqi dhe SNKSP;
- Komuna nuk mban regjistër të ndarë të pronës, pajisjeve dhe impianteve dhe gjithashtu nuk i regjistron ato në SIMFK.
- Duhet të krijohet një sistem i automatizuar i faturimit, dhe në baza të rregullta duhet të bëhet harmonizimi i të hyrave vetanake në mes zyrtarit të të hyrave dhe drejtorive operacionale, dhe duhet të mirren masa për rritjen e të hyrave nga taksat dhe tatimet e ndryshme,
- Përputhshmëria me rregullin financiar 02 – Shpenzimi i parasë publike,
- Duhet të sigurohet respektimi i ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë

Dështimi në zgjidhjen e rekomandimeve tona ka dërguar që të kemi gjetje të njëjta si në vitin 2010

4. Rezultati financiar krahasuar me buxhetin e aprovuar

Analiza e Rezultatit Aktual në Pasqyrat Financiare të krahasuar me Buxhetin e Aprovuar tregon:

Table 1: Përshkrimi i buxhetit dhe shpenzimeve aktuale

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Arkëtimet/ Shpenzimet 2011	Arkëtimet/ Shpenzimet 2010
I.Totali arkëtimet dhe transferet e donacioneve	9,513,658	10,469,504	9,965,837	7,722,164
Granti Qeveritarë-Buxheti	8,798,158	8,884,159	8,748,020	7,068,874
Të hyrat vetanake	715,500	1,120,501	949,992	653,290
Donacionet vendore	-	2,412	2,380	-
Donacionet e jashtme	-	462,432	265,445	-
II.Totali i shpenzimeve	9,513,658	10,469,504	9,965,837	7,722,164
Pagat dhe mëditjet	5,130,263	5,262,956	5,151,331	3,995,808
Mallrat dhe shërbimet	674,947	917,533	876,762	595,938
Shërbimet Komunale	268,712	268,712	268,618	268,109
Subvencionet dhe transferet	123,764	124,085	123,759	119,929
Investimet Kapitale	3,315,972	3,896,219	3,545,366	2,742,380
Rezervat	-	-	-	-
Diferenca I-II	-	-	-	-

Në bazë të të dhënave të paraqitura në tabelën më lartë, ne mund të shohim se buxheti final i Komunës së Rahovecit gjatë vitit 2011 ka qenë 10,469,504 Euro. Total shpenzimet për vitin 2011 kanë qenë 9,965,837 Euro, ose përafërsisht 95% e buxhetit final. Buxheti i pashpenzuar në fund të vitit 2011 ka qenë 503,667 Euro, ose përafërsisht 5% e buxhetit final.

Buxheti final ka qenë më i lartë se buxheti fillestar për total shumë prej 955,846 për shkak të transferimit të të hyrave vetanake nga viti 2010 në shumë prej 405,001 dhe donacioneve në shumë 464,844, përderisa diferenca e mbetur nga Fondi i Përgjithshëm ka të bëjë me rritjen e buxhetit për pagat, e vendosur në nivel qeveritar.

Konkluzion

Bazuar më sipër, Komuna e Rahovecit e ka shpenzuar në total buxhetin për vitin 2011 në përputhje me parashikimet dhe limitet e caktuara nga Kuvendi i Kosovës.

5. Pasqyrat Financiare-Pajtueshmëria me kornizën e raportimit dhe cilësinë e informatave

Kërkesat në ligjin për Menaxhimin e Financave dhe Publike Përgjegjësitë Nr. 03/L-048 dhe Rregulla Financiare 07/2011.

- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar nga Zyrta e Kryesor Administrativ dhe Zyrta e Kryesor Financiar i Komunës së Rahovecit;
- Pasqyrat Financiare janë nënshkruar brenda afatit kohor më 31.01.2012 dhe janë dorëzuar në Ministrinë e Financave dhe gjithashtu janë përmirësuar dhe ridorëzuar më 29.02.2012;
- Pasqyrat Financiare janë dorëzuar vetëm në gjuhën Shqipe; dhe
- Komuna ka përgaditur dhe dorëzuar rregullisht raportet tremujorsh në Ministrinë e Financave gjatë vitit 2011.

1. Rekomandim

Në rekomandime Kryetarit të siguron që përgaditja e pasqyrave financiare të Komunës duhet të përfshijë procedurat dhe mjetet që janë projektuar për të siguruar që informacioni i kërkuar është i regjistruar, përpunuar, përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare. Komuna gjithashtu duhet të përgatis pasqyrat financiare në gjuhën serbe.

6. Menaxhimi Financiar

6.1 Të hyrat (duke përfshirë të hyrat vetanake)

Gjetjet

- Menaxhmenti i komunës nuk ishte në gjendje të paraqes një libër të veçantë e të detajuar të debitorëve të tatimeve dhe taksave. Pa të dhëna të mjaftueshme, të hollësishme dhe të sakta të debitorëve, Komuna nuk është në gjendje të përgadisë buxhet të besueshëm dhe të saktë si dhe të bëjë mbledhjen e të hyrave vetanake në kohën e duhur. Si rezultat, nuk është e mundur të bëhet një harmonizim ose analizë sipas debitorit.
- Gjatë auditimit tonë ne kemi vërejtur se nuk ka një harmonizim të rregullt mujor në mes të departamenteve që arkëtojnë të hyra vetanake, si p.sh.: Departamenti i Tatimit në Pronë, Departamenti i të Ardhurave nga Qeratë, Departamenti i Gjeodezisë, Departamenti i Urbanizimit, etj., edhe pse aty është zyrtari i të hyrave vetanake nga Departamenti për Buxhet dhe Financa, i cili është përgjegjës për harmonizimin dhe qartësimin e diferencave të cilat shfaqen në mes të të dhënave të Komunës dhe SIMFK-ës.
- Gjatë auditimit tonë ne kemi vërejtur se transaksionet nuk regjistrohen në SIMFK në kohën kur ndodhin, p.sh. atëherë kur paguhen. .
- Gjatë auditimit tonë ne kemi vërejtur se të hyrat vetanake nuk regjistrohen në llogaritë e tyre të destinuara si në planin e kontabël.
- Të hyrat vetanake nga participimi në Departamentin e Shëndetësisë nuk transferohen në bankë në baza ditore.

Konkluzioni

Mungesa e saktësisë dhe plotësisë së librave të llogarive të arkëtueshme do të ndikojnë të ardhurat që Komuna mund ti fitoj. Pa regjistrime të mjaftueshme, të hollësishme dhe të sakta të debitorëve dhe raporteve të arkëtimit, Komuna nuk është në gjendje të përgadisë një buxhet të besueshëm dhe të saktë, dhe as të raportoj një përpjestim të saktë të arkëtimeve, e as të ndjekë arkëtimin e të hyrave vetanake në kohën e duhur. Për më tepër, arkëtimi i ulët i të ardhurave do të ndikojë në kapacitetin investues të komunës.

Kontrollet e papërshtatshme dhe të pamjaftueshme në lidhje me të ardhurat dhe në lidhje me programet dhe sistemit e faturimit rrisin rrezikun e manipulimit të shifrave dhe keqpërdorimit të informatave. Një sistem i tillë mund të çojë në faturim jo të plotë dhe të ardhurat jo të plota.

2. Rekomandim

Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që të siguroj që Komuna të ndërmer hapa për përmirësimin e faturimit dhe sistemit kontabël në mënyrë që të sigurohen kontrole të sigurta, efektive dhe efektive në faturim dhe në të ardhura. Përmirësimi i procedurave në lidhje me sisteme të tilla do të mundësojë menaxhmentin të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha, dhe për të siguruar që vendimet që lidhen me buxhetin, planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave janë kryer siç duhet. Ne rekomandojmë që Komuna të:

- Zbatojë një sistem të faturimit që përfshinë detaje të përditësuara në lidhje me pagesit, vendbanimet e tyre aktuale, historinë dhe vlerësimin e arkëtimit. Në një informacion të tillë mund të kenë qasje vetëm një numër i kufizuar i personave dhe vetëm me një autorizim të menaxhmentit;
- Të fus, dhe në mënyrë qendrore të kontrolloj dhe aprovoj tarifatat dhe shkallët e tatimit dhe taksave në sistem në mënyrë që të kalkulohej dhe të gjenerohen fatura automatikisht. Gjenerimi i faturave duhet të autorizohet dhe të rishikohet;
- Ndërlidhë në mënyrë automatike sistemin e faturimit me programin e kontabilitetit në mënyrë që informacionet të procesohen automatikisht në librin kryesorë;
- Lidh automatikisht njësitë operationale dhe të faturimit dhe të kryej harmonizime të rregullta në mes tyre, në rastet kur faturimet janë të lidhura direkt me shërbimet e ofruara nga njësitë operationale
- Performoj rregullisht harmonizim në mes të dy sistemeve për të gjitha llojet e të hyrave. Çdo diferencë nga harmonizimi duhet të ndiqet menjëherë dhe të korrigjohet në kohë;
- Ne e këshillojmë Komunën që të siguroj se paratë e mbledhura nga participimet, të depozitohen në bankë brenda afateve të kërkuara.

6.2 Shpenzimet

6.2.1 Shpërblimet (Pagat dhe Mëditjet)

Gjetjet

Gjatë auditimit tonë ne kemi identifikuar një diferencë në kategorinë e pagave dhe mëditjeve me listën e pagave, në një shumë totale prej 30,560 Euro. Komuna ka paguar këtë shumë nga pagat dhe mëditjet për partnerin implementues “AgroDrinia” të projektit të financuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ZNKE) në lidhje me ndërtimin e deponive të perimeve.

Gjithashtu, gjatë rishikimit të dosjeve të personelit ne kemi vërejtur se disa dokumente të kërkura mungojnë në dosjet e personelit.

Për më tepër, nga testimet e bëra në listat e pagave ne kemi parë se ka raste kur listat nuk kanë qenë të nënshkruara. Një shembull i tillë është gjatë muajit Janar, në departamentin e edukimit primar (93300), lista e pagave nuk është nënshkruar nga shkollat në vijim: Mihail Grameno, Vuk Karadzic, Bajram Curri, S.Markovic, V.Hoca dhe Isa Boletini.

Për më tepër, ka pasur disa raste ku procedurat e rekrutimit nuk janë respektuar ashtu si kërkohen në ligjin për Shërbyesit Civil Nr. 03/L-149, Neni 11.1, rekrutimi përmes njoftimeve publike, dhe gjithashtu ka pasur disa raste të dosjeve të pakompletuara të personelit.

3. Rekomandim

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj se janë nënshkruar të gjitha listat e pagave të të gjithë muajve. Për më tepër, rekrutimi dhe dosjet e personelit duhet të mbahen në mënyrë të rregullt me të gjitha dokumentet e kërkuara me ligjet në fuqi.

6.2.2 Prokurimi

Gjetjet

Gjatë inspektimit të dokumenteve burimore të mostrave të testuara nga ne, ne kemi vërejtur se ka disa mospajtime me procedurat e kërkuara në ligjin mbi Prokurimin Publik në Kosovë. Këto mospajtime janë përshkruar më poshtë:

Në ndërtimin e rrugës: Zoqisht-Reti faza e dytë, me numër të kontratës 62311069521, dhe me vlerë totale 474,824 Euro, ka pasur vonesa në kryerjen e punëve dhe Komuna nuk ka shqiptuar dënime ashtu si është e paraparë me kontratë në rastet kur ka vonesa të kryerjes së punëve. Për më tepër, sigurimi i ekzekutimit të punëve nuk ka qenë valid gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të punëve. Gjithashtu, nuk është mbajtur ditari i punës nga mbikëqyrësi i punëve dhe nuk ka pranim teknik të punëve të kryera.

Në ndërtimin e shtratit të lumit Rimnik me numer kontrate 62311070521, dhe me vlerë totale 344,142 Euro, nuk ka pasur sigurim të ekzekutimit të punëve. Ka pasur vonesa në përmbushjen e kontratës dhe Komuna nuk ka shqiptuar dënime ashtu si është e paraparë me kontratë në rastet kur ka vonesa të kryerjes së punëve. Gjithashtu, nuk është mbajtur ditari i punës nga mbikëqyrësi i punëve dhe nuk ka pranim teknik të punëve të kryera.

Në ndërtimin e rrugës: Zoqisht-Reti-Reti e Ulët (asfaltim) me numër kontrate 62311014521, dhe me vlerë totale 167,002 Euro, zotimi i fondeve nuk është i nënshkruar nga zyrtari i autorizuar. Kryesuesi i komisionit të vlerësimit të ofertave në të njëjtën kohë ka qenë i emëruar edhe mbikëqyrës i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve nuk ka përgaditur raport në lidhje me situacionet e punëve të përfunduara. Komuna nuk ka marrë garancion të punëve të përfunduara me validitet njëvjeçarë ashtu siç është specifikuar në kontratë. Operatorët Ekonomik që kanë marrë pjesë në tender, nuk kanë qenë të njoftuar në lidhje me nënshkrimin e kontratës, ashtu siç kërkohet me nenin 42, pika 4 të ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë. Për më tepër, sigurimi i ekzekutimit të punëve nuk ka qenë valid gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të punëve. Ka pasur vonesa në përmbushjen e kontratës dhe Komuna nuk ka shqiptuar dënime ashtu si është e paraparë me kontratë në rastet kur ka vonesa të kryerjes së punëve.

Në ndërtimin e ndërtesës së Qendrës së Mjekësisë Familjare në fshatin Ratkoc me numër të kontratës 623 11 029 521, dhe me vlerë totale 126,419 Euro, kryesuesi i komisionit të vlerësimit të ofertave, në të njëjtën kohë është emëruar edhe mbikëqyrës i punëve. Mbikëqyrësi i punimeve nuk ka përgaditur raport në lidhje me situacionet e punëve të përfunduara. . Për më tepër, sigurimi i ekzekutimit të punëve nuk ka qenë valid gjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të punëve. Nuk ka pasur komision të pranimit teknik të punëve të kryera. Ka pasur vonesa në përmbushjen e kontratës dhe Komuna nuk ka shqiptuar dënime ashtu si është e paraparë me kontratë në rastet kur ka vonesa të kryerjes së punëve.

Gjatë testimeve tona të dosjeve të prokurimit, ne kemi vërejtur se ka pasur raste kur kriteret për dhënien e kontratës kanë qenë “Çmimi më i ulët” dhe pastaj ka pasur edhe aneks kontrata të nënshkruara me operatorin e njetë për shuma shtesë.

Më poshtë janë të listuara tre raste të projekteve ku është shfaqur kjo çështje:

- Ndërtimi i rrugës Zoqisht-Reti-Reti e Ulët (asfaltim)
- Ndërtimi i rrugëve fushore në Komunën e Rahovecit
- Ndërtimi i rrugëve (qyte-fshatra) në Komunën e Rahovecit

Për më tepër gjatë procedurave të prokurimit, Komuna nuk ka përdorur format standarde të kontratave që janë pjesë e dokumenteve të tenderit dhe që përfshijnë të gjitha kushtet e përgjithshme dhe të veçanta.

Paoshtu, ne kemi identifikuar se Komuna ka bërë pagesa për Shoqatën e Mjekëve të Kosovës (SHMK) në shumën prej 4,650 Euro nga kategoria mallra dhe shërbime pa procedura të prokurimit,

4. Rekomandimet

Ne rekomandojmë Kryetarin që të siguroj që:

Komuna të vendos procedura të mjaftueshme adekuate të kontrollit për monitorimin efektiv të përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret aplikative. Ne i rekomandojmë Komunës të aplikoj në mënyrë të duhur kushtet dhe termet e kontraktuara dhe të shqiptoj denime kur punët nuk përfundohen në kohë. Kjo veçanërisht duhet të aplikohet në rastet kur nuk ka kërkesa për shtyerje të afatit para skadimit të afatit të kontraktuar.

6.2.3 Subvencionet dhe transferet

Gjetjet

Komuna nuk ka politika të shkruara mbi subvencionet, që do të përmbante kriteret për procedurat dhe lejimet e subvencioneve, në mënyrë që subvencionet të lejohen vetëm në bazë të vendimeve të Kryetarit të Komunës.

Konkluzion

Mungesa e komunikimit në kohë dhe e aprovimeve nga autoritetet ose mos kompletimi i dokumentacionit mund të shpie në mospërputhje me kërkesat e Ligjeve dhe Kontratës, dhe në humbje të mëdha.

5. Rekomandim

Komuna duhet të vendos procedura të mjaftueshme adekuate të kontrollit për monitorimin efektiv të përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret aplikative.

6.3 Asetet

6.3.1 Trajtimi i aseteve kapitale dhe jo kapitale

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit, mbajtjes së regjistrimeve dhe menaxhimit të aseteve jo financiare që është në përputhje me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr.21/2209 mbi

Menaxhimin dhe Regjistrimin e asetëve Qeveritare. Ne kemi vërejtur disa mospërputhje me këtë udhëzim administrative:

Gjetjet

Komuna nuk ka procedurë të dokumentuara dhe nuk mirëmban një regjistër të ndarë për pronën, pajisjet dhe impiantet dhe të dhënat kontabël nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK). Për më tepër, Komuna nuk ka finalizuar numërimin vjetorë dhe verifikimin e ekzistencës të mjeteve themelore më 31 Dhjetor 2011, që nuk është në pajtueshmëri me kërkesat e Udhëzimit Administrativ Nr.21/2009 mbi Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare. Komisioni i inventarizimit nuk ka pregaditur raportin e Inventarit në lidhje me inventarizimin e pronës, pajisjeve dhe impianteve si më poshtë:

- Nuk është pregaditur një raport i ndarë për asetet me vlerë jo bartëse, të cilat janë të dëmtuara.
- Nuk është bërë harmonizimi në mes të numërimit fizik dhe të dhënave kontabël për pronën, pajisjet dhe impiantet.

Konkluzion

Komuna nuk ka regjistrime të kompletuara dhe të sakta të asetëve. Kjo dobësi në kontrollin e brendshëm mbi këto asete mund të shpie deri tek papërshtatshëria dhe mos identifikimi në kohën e duhur.

6. Rekomandim

Ne rekomandojmë Kryetarin që të sigurojë që:

Komuna e Rahovecit të zhvillojë dhe të komunikojë një grup të politikave dhe procedurave në lidhje me pronën, ndërtesat dhe pajisjet. Menaxhmenti duhet të kryejë numërimin fizik dhe verifikimin e ekzistencës së të gjitha pasurive materiale të regjistruara në regjistrin e pronës, pajisjeve dhe impianteve në baza vjetore. Artikujt e humbur duhet të hetohen dhe nëse është e nevojshme të çregjistrohen.

Përveç kësaj dhe si minimum, për regjistrat e lartpërmendur duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm për çdo pasuri fikse:

- Datën e përvetësimit
- Vendodhjen
- Numrin e specifikuar nga komuna (numër identifikues)
- Numrin rendor
- Përshkrimi dhe funksioni
- Kosto
- Detajet e zhvlerësimit, duke përfshirë metodat e llogaritjes si për qëllime të taksave po ashtu edhe për qëllime financiare të raportimit
- Jeta e dobishme e parashikuar
- Koston e mirëmbajtjes pas datës së përvetësimit
- Data e nxjerrjes jashtëpërdorimit
- Burimi i financimit
- Numri i faturës për shpenzimin e bërë

6.4 Trajtimi i borgjeve

Detyrimet e papaguara tek furnitorët në fund të vitit 2011 kanë qenë në shumën 277,936 Euro. Këto detyrime janë bartur për tu paguar në vitin 2012.

Gjetjet

Gjatë auditimit tonë, ne kemi identifikuar disa raste kur pagesat janë bërë 30 ditë pas pranimit të faturës, gjë që nuk është në përputhje me dispozitat e Udhëzimeve të Thesarit dhe rregullit financiar 02- të Shpenzimeve të Parasë Publike.

Konkluzion

Duke marrë parasysh të cekurat mëlart, pretendimet e ndryshme ligjore mund të pohohen në të ardhmen dhe kështu ekziston rreziku i dënimeve shtesë që do të vendosen kundër Komunës.

7. Rekomandimet

Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës që të përcjellë dispozitat e Udhëzimeve të Thesarit dhe të rregullit financiar 02 - Shpenzimi i Parasë Publike, të lëshuar nga Qeveria e Kosovës dhe të paguhen borgjet Brenda 30 ditëve.

6.5 Raportimi kohor aktual në procesin e përgjithshëm të buxhetit

Komuna ka përmbushur detyrimet e saj të jashtme. Obligimet e përmbushura janë:

- Kërkesa buxhetore;
- Raportet tremujore duke përfshirë pasqyrat kohore nënmuajore;
- Planin preeliminuar i prokurimit në kohë; dhe
- Raporti i borgjeve i dorëzuar në Ministrinë e Financave

Gjetjet

Gjatë auditimit tonë, ne kemi vërejtur se Komuna nuk ka pregaditur dhe dorëzuar në mënyrë të rregullt mujor, raportin e borgjeve në Ministrinë e Financave gjatë vitit 2011.

8. Rekomandimet

Ne i rekomandojmë Kryetarit të Komunës të sigurojë se Komuna ti konsideron si në vijim:

- Të krijoj kontrolla dhe të merr përgjegjësinë e duhur për të përmbushur kërkesat për raportimin e borgjeve në përputhje me rregullin financiar 04/2011

7. Kontrollet e Menaxhmentit

7.1 Sistemet e kontrollit të brendshëm

Gjatë auditimit kemi vërejtur mangësi në pasqyrat financiare vjetore, menaxhimin e të hyrave, procedurat prokurimit dhe menaxhimin e aseteve ashtu sic është cekur në këtë raport.

Konkluzioni

Zbatimi aktual i kontrolleve të brendshme është në nivel të pamjaftueshëm.

9. Rekomandimet

Ne e rekomandojmë Kryetarin e Komunën që të sigurojë që:

- Kontrollet e përgjithshme financiare ,administrative dhe menaxheriale janë forcuar; dhe
- Se janë marrë veprimet e menjëhershme për sigurimin e një trajtimi më të mire në të metat e identifikuara në zbatimin e kontrollit të brendshëm.

7.2 Sistemi i auditimit të brendshëm

Komuna ka themeluar Komitetin e Auditimit dhe një funksionim të Auditimit të Brendshëm që gjithashtu kërkohet rregulli ligjor Nr. 03/L-128 dhe udhëzimi administrative 11/2010 mbi krijimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit të brendshëm. Komuna ka ndërmarrë veprime me përgjegjësi për të adresuar çështjet e raportuara në raportin e auditimit të vitit paraprak.

Njësia e Auditimit operon me një drejtor dhe dy auditorë. Kjo njësi ka pregaditur një plan strategjik dhe një plan vjetor të auditimit që gjithashtu janë të aprovuara nga Komiteti i Auditimit.

8. Konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e Komunës së Rahovecit

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është që Menaxhmenti i Komunës nuk ka arritur ende që të themelojë sisteme efektive të kontrollit të brendshme. Përveç disa përmirësimeve në fushën e raportimit financiar dhe aseteve, mangësitë janë vërejtur në disa fusha të Menaxhmentit Financiar

Menaxhmenti i Komunës duhet të ngrisë vetëdijen e menaxherëve dhe stafit për nevojën e kontrollit. Kuadri KBFP duhet të shërbejë si një platformë për vendosjen e kontrollit. Nevoja e rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet e organizimit është një nga kërkesat themelore për ndërtimin e një strukture të mirë të qeverisjes.

Menaxhmenti i Komunës duhet të sigurojë në mënyrë të vazhdueshme raportim të besueshëm financiar dhe të vlerësuar nga rreziku i gabimeve materiale në pasqyrat financiare. Rreziku duhet gjithashtu të vlerësohet kur është fjala për pasuritë dhe të ardhurat, kur mungojnë regjistrat dhe regjistrimet e kompletuara.

.

10. Rekomandimet

Ne i rekomandojmë Krytarin e Komunës që të:

- Përpiloj politika të qarta për të gjitha aktivitetet e rëndësishme të Komunës dhe të hartoj një plan veprimi duke specifikuar veprimet e menjëhershme.
- Të Implementoj rekomandimet tona në pikat 3 deri në 7.

Shtojca I. Format e ndryshme të opinioneve të auditimit bazuar në ISSAI 400

(Marrë nga ISSAI 400)

Një opinion auditimi normalisht jepet në njëformat standard, dhe lidhet me pasqyrat financiare në tërësi, duke evituar kështu nevojën për të sqaruar gjerësisht se çfarë qëndron pas tij, por duke bërë të mundur për lexuesit nëpërmjet llojit të tij, të kuptuarit e përgjithshëm të domethënies së tij. Natyra e fjalëve do të ndikohet prej kornizës ligjore për auditimin, por përmbajtja e opinionit do të jetë e nevojshme të tregojë qartë nëse është i pakualifikuar apo i kualifikuar dhe, është i kualifikuar për disa aspekte apo është njëopinion i kundërt (paragrafi 14) ose një refuzim për të dhënë opinion (paragrafi 15).

Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në çdo aspekt material për sa vijon:

- (a) Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza kontabël të pranueshme dhe politika të cilat janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme;
- (b) Pasqyrat janë në përputhje me kërkesat statutorë dhe rregulloret përkatëse;
- (c) Sipas njohurisë së auditorit mbi njësinë e audituar, pamja e paraqitur nga pasqyrat financiare është e qëndrueshme; dhe
- (d) Pasqyrat financiare përmbajnë shpalosjet e duhura të informacionit për të gjitha çështjet materiale.

Theksim i çështjes. Në disa rrethana auditori mund të mendojë se lexuesi nuk do të jetë në gjendje të kuptojë drejt pasqyrat financiare nëse atij nuk i tërhiqet vëmendja për çështje të rëndësishme apo të pazakonta. Si parim i përgjithshëm, auditori që jep një opinion të pakualifikuar nuk u referohet aspekteve të pasqyrave financiare në opinion, nëse ky do keq interpretohej si një kualifikim. Me qëllim evitimin e dhënies së kësaj përshtypje, referimet që kanë kuptimin e “tërheqjes së vëmendjes” paraqitje në një paragraf të veçantë prej opinionit. Megjithatë, auditori nuk duhet të përdorë një tërheqje vëmendje për çështje të cilat lidhen me mungesën e shpalosjes së duhur të informacionit në pasqyrat financiare, dhe as si një alternative apo zëvendësuese të kualifikimit të opinionit

Një auditor mund të **mos jetë në gjendje të shprehë një opinion** të pakualifikuar nëse ekziston ndonjë prej rrethanave të më poshtme dhe sipas gjykimit të auditorit efekti i tyre në pasqyra financiare është ose mund të jetë material:

- (a) Ka pasur kufizim në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron nëse pasqyrat janë të paplota ose keqinterpretuese, ose nëse ka një shmangie të pajustificuar nga standardet kontabël te pranuar; ose
- (c) Ka pasiguri që ndikon në pasqyrat financiare.

Opinion i kualifikuar. Kur auditori nuk është dakord ose është i pasigurt për një ose më shumë zëra të veçantë të pasqyrave financiare, të cilët janë materiale por jo thelbësore për të

kuptuar pasqyrat, duhet dhënë një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm për auditimin, subjekt ky i një deklaratë të qartë dhe koncize për çështjet për të cilat auditori ka kundërshtim apo të cilat krijojnë pasiguri që sjellin kualifikimin e opinionit. Përcaktimi sasior i efektit financiar që vjen prej pasigurisë apo kundërshtimeve nga ana e auditorit, i ndihmon përdoruesit e pasqyrave, megjithëse ky nuk është gjithmonë i mundur apo i rëndësishëm..

Opinion i kundërt. Kur auditori nuk është në gjendje të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare të marra në tërësi, për shkak të kundërshtimeve kaq thelbësore sa e dëmtojnë prezantimin e pozicionit në masën që një opinion i kualifikuar vetëm për disa aspekte do të ishte i papërshtatshëm, jepet një opinion i kundërt. Formulimi i një opinionit të tillë bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë të paraqitura në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe shkurt të gjitha çështjet e kundërshtuara. Përsëri, përcaktimi sasior i efektit financiar ndihmon përdoruesit e pasqyrave, nëse një gjë e tillë është praktike dhe e rëndësishme

Mohim për të dhënjën e Opinionit. Kur auditori nuk është në gjendje të krijojë një opinion mbi pasqyrat financiare të marra në tërësi, për shkak të një pasigurie apo një kufizimi të qëllimit, kaq thelbësor sa një opinion i kualifikuar vetëm për disa aspekte do të ishte i papërshtatshëm, jepet një refuzim për të dhënë opinion. Formulimi i një refuzimi të tillë bën të qartë se nuk mund të jepet një opinion, duke specifikuar qartë dhe shkurt çështjet e pasigurta. Për SAI është e zakonshme që të jepet një raport i detajuar që sqaron opinionin në rrethana kur nuk është e mundur të jepet një opinion i pakualifikuar.

Shtojca II. Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet e implementuara plotësisht	Pjesërisht e implementuar	Nuk është adresuar
1 Pasqyrat Financiare	Përgatitja e pasqyrave financiare te Komunës duhet të përfshij procedure dhe metoda të cilat janë dizenuar për të siguruar që informacioni i kërkuar të jetë regjistruar , procesuar dhe përmbledhur dhe raportuar në mënyrë të përshtatshme në pasqyrat financiare.	Pjesërisht	Faturat e papaguara (obligimeve/kontigjente) dhe faturave tjera (të arkëtueshme) janë paraqitur në pasqyrat financiare. Komuna ka ndërmarrë veprime për të zbatuar rekomandimet lidhur me asetet, por nuk zbatohet plotësisht.	
2.Prona, Pajisjet dhe Impiantet	Ne i rekomandojmë Komunës së Rahovecit të zhvillojë dhe të komunikojë një grup të politikave dhe procedurave në lidhje me pronën, ndërtesat dhe pajisjet. Menaxhmenti duhet të kryejë numërimin fizik dhe verifikimin e ekzistencës së të gjitha pasurive materiale të regjistruara në regjistrin e pronës, fabrikës dhe pajisjeve në baza vjetore. Artikujt e humbur duhet të hetohen dhe nëse është e nevojshme të çregjistrohen. Përveç kësaj dhe si minimum, për regjistrat e lartpërmendur duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm për çdo pasuri fikse: - Datën e përvetësimit	Nuk është zbatuar		.

	<ul style="list-style-type: none"> - Vendodhjen - Numrin e specifikuar nga komuna (numër identifikues) - Numrin rendor - Përshkrimi dhe funksioni - Kosto - Detajet e zhvlerësimit, duke përfshirë metodat e llogaritjes si për qëllime të taksave po ashtu edhe për për qëllime financiare të raportimit - Jeta e dobishme e parashikuar - Koston e mirëmbajtjes pas datës së përvetësimit - Data e nxjerrjes jashtëpërdorimit - Burimi i Financimit - Numri i faturës për shpenzimin e bërë. <p>Për mëtej, dhe për qëllim të ofrimit të një sigurimi adekuat të aseteve të saj, që duhet të kryhet rregullisht dhe të paktën një herë në vit, numërimi fizik i pronës, pajisjeve dhe impianteve. Të dhënat kontabël duhet të harmonizohen me rezultatet e këtij numërimi.</p>			
3 Të hyrat	<p>Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj që Komuna të ndërmerri hapa për përmirësimin e faturimit dhe sistemit kontabël në mënyrë që të sigurohen kontrole të sigurta, efektive dhe të ardhura. Përmirësimi i procedurave në lidhje me sisteme të tilla do të mundësojë e menaxhmentin të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e</p>	Nuk është zbatuar		

<p>mëdha, dhe për të siguruar që vendimet që lidhen me buxhetin, planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave janë kryer siç duhet. Ne rekomandojmë që Komuna të:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që të siguroj që Komuna të ndërmer hapa për përmirësimin e faturimit dhe sistemit kontabël në mënyrë që të sigurohen kontrole të sigurt, efikase dhe efektive në faturim dhe në të ardhura. Përmirësimi i procedurave më lidhë me sisteme të tilla do të mundësojë të menaxhmentin të monitorojë dhe menaxhojë rreziqet e mëdha, dhe për të siguruar që vendimet që lidhen me buxhetin, planifikimin dhe arkëtimin e të ardhurave janë kryer siç duhet. Ne rekomandojmë që Komuna të. -Të fus dhe në mënyrë qendrore të kontrolloj dhe aprovoj tarifatat dhe shkallët e tatimit dhe taksave në system në mënyrë që të kalkulohen dhe të gjenerohen fatura automatikisht. Gjenerimi i faturave duhet të autorizohet dhe të rishikohet. - Ndërlidhë në mënyrë automatike sistemin e faturimit me programin e kontabilitetit në mënyrë që informacionet të procesohen automatikisht në librin kryesorë. - Performoj rregullisht harmonizim në mes të dy sistemeve për të gjitha llojet e të hyrave. Çdo diferencë nga harmonizimi duhet të ndiqet menjëherë dhe të korigjohet në kohë. 			
--	--	--	--

	-Lidh automatikisht njësitë operacionale dhe të faturimit dhe të kryej harmonizime të rregullta në mes tyre, në rastet kur faturimet janë të lidhura direkt me shërbimet e ofruara nga njësitë operacionale			
4 Shpenzimet	Mungesa e pagesës dhe dokumenteve mbështetëse.	Pjesërisht		
4.1 Shpërblimet (Pagat dhe Mëditjet)	Disa dosje nuk kanë të gjithë dokumentacionin e kërkuar.	Nuk është zbatuar		
4.2 Subvencionet dhe Transfer	Mungesa e pagesës dhe dokumenteve mbështetëse	Nuk është zbatuar		
5 Prokurimi	Komuna duhet të vendos procedura të mjaftueshme adekuate të kontrollit për monitorimin efektiv të përputhshmërisë me rregulloret dhe ligjet aplikative, dhe veçanërisht me kërkesat e Ligjit mbi Prokurimin Publik.	Nuk është zbatuar		
7.2 Sistemet Auditimit të brendshëm	Komuna nuk ka themeluar Komitetin e Auditimit. Komuna nuk ka ndërmarrë veprime me përgjegjësi për të adresuar çështjet e raportuara në raportin e auditimit të vitit paraprak.	E Implementuar	Komuna ka ndërmarrë hapa në themelimin e Komitetit të Auditimit.	

Shtojca III. Komentet e Komunës dhe përgjigjet e Auditorit

Rekomandimet	Pajtohet	Pjesërisht Pajtohet	Nuk Pajtohet	Komentet e Komunës	Përgjigjia e Auditorit
1. Pasqyrat Financiare				<p>Konsiderojmë se, pasqyra e pranimit dhe pagesave me para të gatshme është e kompletuar dhe në përputhje të plotë me nenin 12 të shpalosjes sipas rregullave financiare nr.07/2011</p> <p>Konsiderojmë se, neni 15 shpalosja 35 janë të prezantuar në pasqyrat financiare që kanë të bëjnë me detyrimet e pa pagura dhe detyrimet kontigjente. Si shtojcë komentit i bashkëngjesim listën e borxheve për mallra dhe shërbime dhe për investime kapitale</p> <p>Gjatë vitit 2011, Komuna e Rahovecit nuk ka pasur pagesa nga palët e treta dhe nuk janë prezantuar në pasqyrat financiare</p> <p>Neni 21 ku thuhet se, organizatat buxhetore duhet t'i</p>	Gjetjet e auditorit qëndrojnë

Rekomandimet	Pajtohet	Pjesërisht Pajtohet	Nuk Pajtohet	Komentet e Komunës	Pergjigjia e Auditorit
				<p>respektojnë afatet e dorëzimit të raporteve financiare, Komuna Rahovecit i ka respektuar këto afate. Si dëshmi shënime mund t'i gjeni në Ministrinë e Financave, konkretisht në Departamentin e Thesarit, ndërsa neni 27 nuk ekziston në rregullën financiare nr 07/2011.</p>	
2. Të hyrat				<p>Konsiderojmë se, të arkëtushmet janë të kompletura në mënyrë të duhur, me përjashtim të arkëtushmet nga tatimi në pronë, sepse softwer-i ekzistues që është i instaluar në të gjitha komunat e Kosovës nuk përpunon të dhëna në mënyrë analitike, por të dhënat i përpunon në total. Shtojcë komentit ia bashkëngjitem listën e llogarive të arkëtushme nga taksa e biznesit dhe listën e arkëtushme nga qiraja.</p> <p>Komuna e Rahovecit nuk ka system të automatizuar të faturimit të llogarive të arkëtushme, pos tatimit në pronë dhe këtë besoj se do ta bëjmë shumë shpejt, por komuna jonë mban lista dhe llogari të veçantë për të gjithë debitorët. Shtojcë komentit i bashkëngjitem listën e llogarive të arkëtushme nga taksa e biznesit dhe listën e arkëtueshme nga qiraja.</p> <p>Është e pa mundur që transaksionet të regjistrohen në SIMFK në ditën kur ndodhin, por ato regjistrohen në ditën e nesërme dhe këtë e regjistrim e bën rregullisht</p>	Gjetjet e auditorit qëndrojnë

Rekomandimet	Pajtohet	Pjesërisht Pajtohet	Nuk Pajtohet	Komentet e Komunës	Pergjigjia e Auditorit
				<p>zyrtari i tatimit të të hyrave.</p> <p>Të hyrat vetanake regjistrohen sipas kodeve ekonomike , konkretisht sipas standardit të unifikuar për numra referent për grumbullimin e të hyrave publike të lëshuar nga Ministria e Financave. Shtojcë komentit i bashkëngjirim formularin e regjistrimit të të hyrave vetanake</p>	
3. Shpërblimet (Pagat dhe Mëditjet)				<p>Vlera e grantit të fituar nga Komisioni Evropian është 294.000,00 €. Kjo shumë e buxhetit është e ndarë sipas kategorive: për mallra dhe shërbime, investime kapitale, dhe për paga dhe meditje. Shuma prej 30.560,00 € është e dedikuar në pozicionin paga dhe mëditje. Këtë shumë komuna jonë e ka bërë vetëm transferë-shpenzim të mjeteve në llogari të partnerit implementues “Anadrini” {e jo Agrodrinia} në emër të projektit Pika Grumbulluse për pemë dhe perime në fshatin Xerxë, e jo nga lista e pagave dhe mëditjeve të komunës. Shtojcë: komentit ia bashkëngjirim CPO-në të dalë nga Thesari.</p> <p>Në muajin janar 2011 listat e pagave kanë ardhur me rritje (50%) gabim ky i Ministrisë së Financave dhe është kërkuar të nënshkruhen, gjë që është bërë nga të gjithë punëtorët e arsimit. Mirëpo, në fund të muajit janar kanë ardhë listat e reja, pa rritje, për muajin e njëjtë. Edhe pse shumica e mësimitdhënësve i kanë</p>	Gjetjet e auditorit qëndrojnë

Rekomandimet	Pajtohet	Pjesërisht Pajtohet	Nuk Pajtohet	Komentet e Komunës	Pergjigjia e Auditorit
				<p>nënshtuar edhe listat e dyta për muajin e njëjtë, një pjesë e vogël kanë refuzuar që të nënshtojnë listat e dyta për muajin e njëjtë. Përjashtim bëjnë listat e punëtorëve serb, të cilët asnjëherë nuk i nënshtojnë listat e pagave edhe pse shumë herë u janë dërguar për nënshtim</p> <p>U.D i Udhëheqësit të personelit: Tërësisht është i përvetësuar ky konstatim ose e gjetur e Auditorit të Përgjithshëm, sepse asnjë pranim në punë gjatë vitit 2011 nuk është bërë pa njoftim publik –konkurs publik dhe rekrutimi i punëtorëve është bërë në pajtim me procedurat e Ligjit për Shërbyesit Civil Nr. 03/L-149 si dhe rregulloren e MAP-së nr.2/2010 për procedurat e Rekrutimit. Gjithashtu dosjet e punëtorëve të pranuar në punë gjatë vitit 2011 janë të kompletuara me dokumentet e obligueshme, siç kërkon rregullorja e MAP-së nr.03/2011 mbi dosjet dhe regjistrin qendror të nëpunësve civil. Duhet sqaruar një fakt, dosja personale e punëtorit dallon prej dosjes së konkursit dhe të dyja këto dosje kanë trajtim të ndryshëm dhe arkivohen ndaras. Ne konsiderojmë se ky konstatim i AP-së është i përgjithësuar dhe jo i përvetësuar.</p>	
4. Prokurimi				Ju njoftojmë se nuk kemi vonesa në lidhje me këtë kontratë përkundrazi puna po kryhet në afat para kohe,	Gjetjet e auditorit qëndrojnë

Rekomandimet	Pajtohet	Pjesërisht Pajtohet	Nuk Pajtohet	Komentet e Komunës	Pergjigjia e Auditorit
				<p>duke u bazuar me planin dinamik të ofruar nga O.E. Duhet përmendur se punët ekzekutohen në bazë të planit dinamik të përcjellë nga Organi mbikëqyrës, i cili evidenton çdo fazë dhe çdo ngecje, sidomos periudhën dimërore, kushtet atmosferike apo ndonjë problem pronësor.</p> <p>Deklaroni se sigurimi i ekzekutimit nuk ka qenë valid gjatë periudhës së ekzekutimit,</p> <p>Ju njoftojmë se, sigurimi i ekzekutimit është gjashtë muaj dhe ka validitet dyfish më shumë se sa Plani Dinamik për kryerjen e punëve (90 ditë).</p> <p>Ju njoftoj se, është e vërtetë që nuk është gjetur në sigurimin e ekzekutimit të punimeve në dosjen e tenderit, d.m.th nuk ka qenë fizikisht në dosjen e tenderit por ka qenë në dosjen e ofertuesit, e që ka validitet deri më 01.01.2013.</p> <p>Edhe në këtë tender nuk kemi vonesa të ekzekutimit të punimeve, sepse punët janë në vazhdim, sipas planit dinamik dhe nuk ka pranim teknik për kryerjen e punëve, sepse punët ende nuk kanë përfunduar.</p> <p>Ju njoftojmë se, O.E e ka ofruar sigurimin e ekzekutimit në bazë të Planit Dinamik dhe është zotuar se, punët do të kryehen në afatën e paraparë, mirëpo për shkak të kushteve atmosferike dhe disa problemeve pronësore me komunitetin, janë krijuar vonesa që nuk kanë të bëjnë me kryesit e punimeve.</p> <p>Organi mbikëqyrës nuk e ka bërë raport për përfundimin e punëve, sepse pas analizës dhe shqyrtimit të elaboratit të mostrave të asfaltit të shtruar,</p>	

Rekomandimet	Pajtohet	Pjesërisht Pajtohet	Nuk Pajtohet	Komentet e Komunës	Pergjigjia e Auditorit
				<p>trashësia është më e vogël se sa e kërkuar. Kërkohej nga O.E.që në afat sa më të shkurtër kohora ta bëjë stabilizimin e pjesës së kërkuar të rrugës dhe asfaltim të sërishëm në pjesët e kërkuara. A.K.Komuna e Rahovecit ka bërë ndalesën e pagesës 10%nga vlera e kontratës Raporti i Organit mbikëqyrës tani ndodhet në dosjen e tenderit me të gjitha mostrat dhe vërejtjet e cekura.</p> <p>Ju njoftojmë se gjatë periudhës së auditim, punët kanë qenë në vazhdim dhe të pa përfunduara, prandaj mbikëqyrësi nuk ka bërë raport përfundimtar. Prandaj, nuk ka pasur as komision të pranimit teknik të punëve të kryera, pasi që punët janë të pa përfunduara.</p> <p>Si zyrë e prokurimit, ende nuk e dimë se a ka vonesa apo jo në ekzekutimin e punimeve deri sa nuk ka arritur raporti përfundimtar i organit mbikëqyrës, që e ka përcjellë punë në bazë të planit dinamik.</p> <p>Validiteti i sigurimit të ekzekutimit po praktikohet në tërë Kosovën në bazë të planit dinamik për kryerjen e punimeve, ngase rrallë ndodh të ketë voensa për fajin e O.E. Vonesat po paraqiten nga arsyet e ndryshme siç u cekln më sipër.</p>	
5. Subvencionet dhe Transfer				Nuk ka koment	
6. Prona, Pajisjet dhe Impiantet				Komuna e Rahovecit brenda vitit 2011 ka formuar komisionin për regjistrimin dhe vlerësimin e pasurisë,	Gjetjet e auditorit qëndrojnë

Rekomandimet	Pajtohet	Pjesërisht Pajtohet	Nuk Pajtohet	Komentet e Komunës	Pergjigjia e Auditorit
				komisioni ka bërë vlerësimin e pasurisë së komunës, por nuk ka mundur brenda afatit të përcaktuar me ligj të fusë të dhënat në sistemin free balance, këto të dhëna iu janë afruar si dëshmi auditorëve të jashtëm.	
7. Trajtimi i borgjeve				Nuk ka koment	
8. Raportimi kohor aktual në procesin e përgjithshëm të buxhetit				Nuk ka koment	
9. Sistemet e kontrollit te brendshëm				Nuk ka koment	
10. Konkluzion i përgjithshëm mbi menaxhmentin e Komunës së Rahovecit				Nuk ka koment	



Grant Thornton

An instinct for growth™

www.grant-thornton.com.mk